



**BASHKIA
TIRANË**
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 49, datë 06.04.2021

**“PËR
MIRATIMIN E TREGUESVE TË REALIZIMIT TË BUXHETIT
TË BASHKISË TIRANË PËR VITIN 2020”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 44, nenit 54 dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 51, të ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimit nr. 2, datë 20.01.2020, të ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,


VENDOSI:

1. Miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020, sipas pasqyrave bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar dhe të gjitha institucionet në varësi të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZV/KRYETARI

LUAN BREGASI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT TIRANË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 6011 Prot.

Tiranë më 13.4.2021

Lënda: Verifikim ligjshmërie

KËSHILLIT TË BASHKISË TIRANË

Tiranë

Bazuar në Ligjin nr.107/2016, dt.27.10.2016 « Për Prefektin » dhe Ligjin nr. 139/2015, « Për vetëqeverisjen vendore », Prefekti i Qarkut Tiranë, verifikoi ligjshmërinë e **Vendimeve nr.49-62 datë 06.04.2021** të Këshillit të Bashkisë Tiranë. Për sa më sipër:

Vendimi nr. 49, dt.06.04.2021 “Për miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020“ është në përputhje me Ligjin nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Vendimi nr.50, dt.06.04.2021 “Për krijimin e lehtësirave fiskale ndaj biznesit në kuadër të masave për përballimin e pasojave të infeksionit covid-19” është në përputhje me Ligjin nr.9632, dt.30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“, i ndryshuar dhe Ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Vendimi nr.51, dt.06.04.2021 ”Për një shtesë dhe disa ndryshime në vendimin nr.172, dt.21.12.2020 të Këshillit Bashkiak të Tiranës « Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2021 (i ndryshuar) » është në përputhje me Ligjin nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

të rindërtimit” është në përputhje me Aktin Normativ nr.9, dt.16.12.2019 “Për përballimin epasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Vendimi nr.60, dt.06.04.2021 “Për Klubin Sportiv Tirana” është në përputhje me VKM nr. 687, datë 14.11.2018 “Për kriteret, mënyrën e shpërblimit dhe përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive të sportistëve, që përfitojnë statusin e nivelit të lartë”.

Vendimi nr.61, dt.06.04.2021 “ Për disa korrigjime gabimi material në vendimet e listave të përfituesve nga granti i rikonstruksionit dhe programi i rindërtimit” është në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Vendimi nr.62, dt.06.04.2021 “Për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Tiranë” është në përputhje me Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

PREFEKT

MERSIN MURATAJ

